

**VENDIM**  
**Nr. 410, datë 15.6.2022**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1144, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR  
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT ‘ATRIUM CENTER THUMANA’,  
NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIJË, DHE CAKTIMIN E  
BASHKISË KRUIJË SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 1144, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Krujë, për rindërtimin e objektit “*Atrium Center Thumana*”, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, në masën 176 168 718 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet Bashkisë Krujë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**